



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 41, datë 28.05.2015**

**PËR**

**LICENCIMIN E ZJ. VALBONA KADUKU SI VLERËSUES DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar, të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e Zj. Valbona Kaduku në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime me cilësimin, Vlerësues i dëmeve materiale (*motorike*) dhe vlerësues i dëmeve shëndetësore, në këto grupe sigurimi të Jo-Jetës:
  - Sigurim i aksidenteve dhe i shëndetit;
  - Sigurime motorike.
2. Licenca shoqërohet me deklaratën personale të nënshkruar nga vlerësuesi, sipas formatit bashkëlidhur.
3. Ngarkohet drejtoria përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Enkeleda SHEHI**

Tiranë, më ...../...../2014

### **DEKLARATË PERSONALE**

Unë i nënshkruari ....., deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se në zbatim të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, dhe Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” të ndryshuar, do të ushtroj veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në mënyrë të pavarur, në përputhje me standardet profesionale dhe do të zbatoj kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurimeve dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Jam i ndërgjegjshëm dhe pranoj se mos plotësimi i kërkesave të mësipërme mund të jetë subjekt i masave të marra nga Bordi i AMF-së deri në tërheqjen e licencës.

Me respekt

---